

Tashmë është traditë që rinia sindikaliste e BSPSH-së të festojë 22 marsin, Ditën e Rinisë Sindikaliste të BSPSH- së.

Kjo ditë simbol i demokracisë në Shqipëri e përzgjedhur nga Presidenti i BSPSH-së z.Gëzim Kalaja simbolizon të gjithë kontributin e rinisë punëtore dhe asaj shkollore për rrëzimin e sistemit komunist dhe zhvillimin e proceseve demokratike në Shqipëri.

Në këtë aktivitet të rëndësishëm morën pjesë rreth 100 anëtarë të Rrjetit Rinor që përfaqësojnë sindikatat e profesioneve të: Minierave ,Arsimit, Shëndetësisë, Tipografisë, Artit, SPILT, Ndërtimit, Telekomit etj.

Aktivi u hap nga znj.Elona Preza , Kryetare e Rrjetit Rinor të BSPSH-së, e cila mbasi i njohu pjesëmarrësit me aktivitetet e zhvilluara të rinisë sindikaliste për vitin 2012 shtroi objektivat dhe detyrat që i dalin këtij Rrjeti mbështetur në Objektivat e Mijëvjeçarit të PNUD (United Nations Development Programme) .

Më pas Presidenti i BSPSH z.Gëzim Kalaja përshëndeti të rinjtë pjesëmarrës në këtë event. Ai i njohu ata me historinë e lëvizjes sindikaliste që nga viti 1991 dhe kontributin e të rinjve në të gjitha arritjet dhe zhvillimet e BSPSH.

Presidenti BSPSH-së duke bashkëbiseduar me të rinjtë shtroi para tyre disa detyra me rëndësi jetike që BSPSH i beson rinisë , si:

- Shtimin e radhëve të sindikatës më anëtarë të rinj dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimarrje, detyrë kjo e dalë nga objektivat e Kongresit të V të BSPSH dhe
- zbatimi i detyrave të rëndësishme që dalin nga Deklarata e Mijëvjeçarit :

Gjithashtu , midis të tjerave Presidenti i BSPSH z.Gëzim Kalaja i premtoi Rrjetit Rinor mbështetje të pakufishme për të gjitha aktivitetet si , fushata , aksione që do të zhvillojë rinia në kuadrin e realizimit të objektivave të mijëvjeçarit,duke i konsideruar ata, të rinjtë sindikalistë , si e ardhmja për vazhdimin e luftës sindikale në interes të mbrojtjes të të drejtave social-ekonomike të punonjësve sipas standardeve bashkëkohore.

Në këtë ceremoni z. Kalaja i dorëzoi Rrjetit Rinor Flamurin e Rinisë Sindikaliste të BSPSH-së me mbishkrimin: “ **22 Marsi Dita e Rinisë Sindikaliste të BSPSH**”





Mëkroni në këtë ishfaqe aktivi doli me këtë deklaratë:  
Kështu përshëndetëm dhe një ditë të re për bashkimin dhe bashkëpunimin në tërësi të shoqërisë